



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, nxjerr:

VENDIM **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN** **E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË BRENDSHËM** **TË DATËS 25.03.2019**

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për pozitën; *Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë*, në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, sipas konkursit të brendshëm me nr. prot. 13-111/01-25022/19, të datës 25 mars 2019, ngritet Komisioni përzgjedhës ad-hoc, në përbërje:

- | | |
|-------------------|----------|
| 1. Ismet Uka | kryesues |
| 2. Kadrie Ajvazi | anëtare |
| 3. Naim Salihu | anëtar |
| 4. Halit Vërshevc | anëtar |
| 5. Nazmi Elezi | anëtar |

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, Rregulloren 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Nr. prot.02-020/04-0025442/19
Podujevë, 02 prill 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore 2020-2021 nr.01-400/03-0078667/18, dt. 26.09.2018, në rekomandim të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0005659/19, dt. 25.01.2019, merr:

VENDIM

PËR NDARJEN E SERRAVE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Ndahen 100 (njëqind) serra për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Përkrahja e fermerëve në projektin për ndarjen e serrave, në madhësi nga 100 m²”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Ndarja e serrave bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0025938/19
Podujevë, 05 prill 2019





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 10 parag.1 shkronja b) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19 për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE SHOQËRINË BJESHKATARE ALPINISTE - LLAPI

Neni 1

Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste - SHBA Llapi, për realizimin e marshutës memoriale për nderë të ish anëtarit Agim Kikaj, dhe emërtimit të shtegut me emrin e të ndjerit, mbështetet me mjete financiare, në shumë 1,000.00 €.

Neni 2

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e z.Abdullall Softolli, përfaqësues i autorizuar i SHBA Llapi.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/04-0022919/19
Podujevë, 15 prill 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, nxjerr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË BRENDSHËM TË DATËS 03.04.2019

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për pozitën; *Drejtor i Qendrës për Punës Sociale*, sipas konkursit të brendshëm me nr. prot. 13-111/01-28450/19, të datës 03 prill 2019, ngritet Komisioni përzgjedhës ad-hoc, në përbërje:

- | | |
|-------------------|----------|
| 1. Ismet Uka | kryesues |
| 2. Kadrie Ajvazi | anëtare |
| 3. Naim Salihu | anëtar |
| 4. Halit Vërshevc | anëtar |
| 5. Nazmi Elezi | anëtar |


Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, Rregulloren 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot.02-020/04-0032292/19
Podujevë, 16 prill 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Shtatëdhjetë e një (71) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 7800 €.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.


Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.


Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/01-0033150/19
Podujevë, 18 prill 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, merr,

VENDIM PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES

Neni 1

Për hartimin e;

- **Propozim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave, dhe**
 - **Propozim Rregullores për mbrojtje të mjedisit**
- n'funksion të implementimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe OJQ – Ekovizioni, të datës 17 prill 2019, ngritet Grupi punues, në këtë përbërje:

1. **Nexhmi Rudari**, *Nënkryetar i Komunës, kryesues*
2. **Faik Muçiqi**, *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, zv. kryesues*
3. **Hamdi Jaha**, *Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar*
4. **Durim Salihu**, *Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, anëtar*
5. **Shpend Sopa**, *Drejtor ekzekutiv i OJQ – Ekovizioni, anëtar*
6. **Rizah Muçolli**, *zyrtar për mbrojtje të mjedisit, anëtar*
7. **Eset Abdullahu**, *inspektor i mbrojtjes së mjedisit, anëtar*
8. **Shaban Beselica**, *menaxher i KRM 'Pastrimi' - Njësia Podujevë, anëtar*
9. **Faik Haliti**, *përfaqësues i 'Natyra' sh.p.k., anëtar*
10. **Donjeta Sheqiri**, *përfaqësuese e shoqërisë civile, anëtare*
11. **Enver Hyseni**, *përfaqësues i mediave lokale*
12. **Bujar Gimolli**, *zyrtar për informim dhe komunikim me publikun, anëtar*
13. **Muhamet Maloku**, *ekolog, anëtar*

Neni 2

1. Grupi punues sipas nenit 1 të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin nga fushëveprimataritë përkatëse, hartojnë dhe përgatitin draftet finale të propozim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave, dhe propozim Rregullores për mbrojtje të mjedisit.
2. Propozim dokumentet përmes Drejtorëve të Drejtorive të fushveprimtarive përkatëse, i prezantohen Kryetarit të Komunës, para se të njëjtat të procedohen për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Neni 3


Punët, detyrat dhe aktivitetet tjera të Grupit punues, ndër të tjera janë të parapara edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe OJQ – Ekovizioni, të datës 17 prill 2019.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Anëtarëve
Arkives

Nr. 02-020/04-0033331/19
Podujevë,
18 prill 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 30.2 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nr. 06/L-085, merr;

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM

Neni 1

Zyrtar përgjegjës për sinjalizim n'kuadër të Komunës e Podujevës, caktohet:

z. Arsim Mehmeti, udhëheqës i sektorit të kadastrit në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

E-mail; arsim.h.mehmeti@rks-gov.net

Voip: 038 200 41-058

Tel mob.: 045/663-757

Neni 2

Zyrtari përgjegjës detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe akteve tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore që i referohen fushëveprimit nga funksioni që ushtron.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:

Të caktuarit

Agjencisë Kundër Korrupsionit

Arkivës

Nr.prot. 02-016/01-0035379/19
Podujevë, 26 prill 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu